

VENDIM
Nr. 225, datë 21.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 432, DATË 13.7.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË
SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit” dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 2, “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 7 riformulohet, si më poshtë vijon:

“7. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, që marrin pagën sipas niveleve të klasifikimit të këtij vendimi, u jepet shtesë për vështirësi vendi dhe zone:

a) Për punonjësit e klasave 1.1 deri 1.4, të nivelit I, të lidhjes nr. 1, në masën deri në 30% të pagës bazë mujore;

b) Për punonjësit e klasave 1.5 dhe 1.6 të nivelit I, si dhe për punonjësit e niveleve II, III dhe IV, të lidhjes nr. 1, në masën deri në 50% të pagës bazë mujore.

Masa e shtesës për çdo vend pune brenda kufijve si më sipër, vështirësia e funksionit si dhe kriteret për përfitimin e shtesës mbi pagë përcaktohen me urdhër të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

2. Efektet financiare të këtij vendimi, për shkak të politikës për rritjen e pagave, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikatat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 2
STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR
PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	30000	1%	2%
		I.2	31600	1%	2%
		I.3	35000	1%	3%
		I.4	38500	1%	5%
		I.5	43600	1%	6%
		I.6	45000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	48000	1%	8%
		II.2	52000	1%	12%
		II.3	54000	1%	12%
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	57000	1%	14%
		III.2	59000	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	63000	1%	20%
		IV.2	68100	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në SHISH		134000	0%	0%